



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 653/25 Dt. 30.12.2025



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren  
Prizren Beledijesi

Njësia e Auditimit të Brendshëm  
Departament Interne Revizije  
İc denetim-Birimi-Internal Audit-Department

# PLANI VJETOR

PËR NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM  
NË KOMUNËN E PRIZRENIT

# 2026

Prizren, dhjetor 2025

**PËRMBAJTJA**

I. Hyrje.....	3
II. Aktivitetet e njësisë së auditimit të brendshëm për arritjen e objektivave strategjike .....	3
III. Detyrat e auditimit.....	4
IV. Radhitja e detyrave të planifikuara të auditimit me strategjinë e auditimit.....	8
V. Planifikimi i burimeve dhe ndarja e detyrave të auditimit .....	10
VI. Aprovimi i planit vjetor.....	11

## I.HYRJE

Plani vjetor për vitin 2026 i detyrave dhe aktiviteteve për auditim të brendshëm është përpiluar në bazë të planit strategjikë 2026-2028. Ky plan përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit. Detyrat e auditimit për vitin 2026 ndahen në bazë të kapaciteteve aktuale në personel në NjAB. Bazuar në Ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike, Ligjin mbi menaxhimin me financa publike, Udhëzimet Administrative, Instruksionet financiare në fuqi, si dhe objektivat e organizatës buxhetore, NjAB do ta bëjë auditimin të bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit dhe metodologjinë për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm.

Plani vjetor mund të rishqyrtohet dhe të azhurnohet gjatë vitit sipas nevojës, në mënyrë që të mund të pasqyrohen ndryshimet më rëndësi që ndodhin në organizatë, apo në NjAB, si dhe detyrat shitesë që propozohen nga udhëheqësi i organizatës.

Çdo ndryshim i planit vjetor do të përgatitet nga Udhëheqësi i Auditimit të Brendshëm dhe miratohet nga Zytari Kryesor Administrativ i Organizatës Buxhetore (Kryetari i Komunës).

## II.AKTIVITETET E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Me këtë plan parashihen edhe elementet kryesore të kontrollit të brendshëm në mënyrë që menaxhmentit të lartë të ju jepet një siguri për sistemet për të cilat janë përgjegjës, që të dizajnojnë, implementojnë dhe kontrollojnë punën që e kryejnë në përputhje me Ligjet dhe rregullat në fuqi.

Në vitin 2026 Njësia e Auditimit të Brendshëm planifikon realizimin e detyrave dhe aktiviteteve në vijim për arritjen e objektivate të theksuara në planin strategjik.

Nr	Objektivat kryesore për vitin 2026	Aktivitetet për përmbushjen e objektivate	Detyrat
1	Rishikimi i aktiviteteve të komunës dhe vlerësimi i menaxhimit ligjor, efektiv dhe të qëndrueshëm	Sigurimi i menaxhmentit të lartë të Komunës se aktivitetet për arritjen e objektivate janë në pajtueshmëri me ligjet, rregulloret, politikat, procedurat.	Të sigurohet që menaxhmenti i lartë të jetë në dijeni dhe të zbatojë plotësisht kërkesat ligjore.
2	Përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të organizatës	Rishikimi i funksionimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në të gjitha drejtoritë. Vlerësimi i efektivitetit të proceseve të monitorimit, miratimit dhe raportimit.	Të sigurohet menaxhmenti për nivelin e kontrollit të brendshëm dhe nevojën për përmirësime. Të jepen rekomandime konkrete për rritjen e transparencës dhe sigurisë financiare.
3	Menaxhimi (identifikimi, analiza dhe vlerësimi) i rrezikut nga menaxhmenti i Komunës.	Sigurimi i menaxhmentit për rëndësinë e analizimit dhe menaxhimit të rrezikut në të gjitha nivelet.	Vlerësimi i shkallës së rrezikut sipas rëndësisë dhe analiza e kësaj shkalle.
4	Përcaktimi i 'universit të auditimit' që përfshinë të gjitha fushat dhe aktivitetet në organizata të cilat mund t'i nënshtrohen auditimit të brendshëm;	Rishikimi i fushave/aktiviteteve OB, duke ofruar vlerësimin e rreziqeve, objektive dhe rekomandime për përmirësim.	Dhënia e sigurisë së arsyeshme menaxhmentit për vlerësimin e drejt të mjedisit dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi

5	Të kuptuarit për rolin e auditimit të brendshëm në shërbim të dhënies së përkrahjes për menaxhmentin e organizatës.	Monitorimi i efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve të brendshme në organizatë. Dhënia e këshillimeve gjatë zbatimit të procedurave apo ndryshimeve në proceset punuese.	Të vlerësohen objektivat e organizatës dhe rezultatet e arritura. Të ofrohen shërbime sigurie dhe këshillimi për t'i ndihmuar menaxhmentit në vendimmarrje.
---	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### III.DETYRAT E AUDITIMIT

#### 3.1. Detyrat audituese të pa përfunduara gjatë vitit 2025

Detyrat e Auditimit për vitin 2025 janë duke u kryer në bazë të planit të punës dhe sipas dinamikës së aktiviteteve që janë duke u kryer synojmë që deri në fund të vitit të përmbushet plani i punës për vitin 2025. Nga plani i vitit 2025 do të vazhdohet me procesin e verifikimit të zbatueshmerisë së rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm, ashtu që të gjeturat nga ky verifikim të paraqiten në Raportin Vjetor të NJAB-së deri me 15.01.2026.

#### 3.2. Llojet e detyrave të auditimit për vitin 2026

Pas vlerësimit dhe analizës së sistemeve kryesore në organizatën buxhetore, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) për vitin 2026 ka planifikuar realizimin e detyrave audituese në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik. Detyrat audituese janë klasifikuar sipas shkallës së rrezikut, përkatësisht: katër (4) auditime me rrezik të lartë dhe dy (2) auditime me rrezik të mesëm.

Një nga auditimet e parashikuara në Planin Strategjik si auditim me rrezik të mesëm nuk do të realizohet gjatë vitit 2026, ndërsa ditët e planifikuara të punës, gjithsej njëzetë(20) ditë, janë rialokuar për Auditimin e Performancës në menaxhimin e subvencioneve dhe transfereve (DBZHR).Ky riorientim është bërë për shkak të kompleksitetit më të lartë të kësaj fushe dhe nevojës për angazhim më të madh kohor për realizimin cilësor të detyrës audituese, si dhe mungesës së auditorëve të brendshëm në NjAB. Gjithashtu, NjAB ka paraparë angazhim të rregullt periodik dhe vjetor për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, me qëllim të forcimit të llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Sa i përket detyrave të tjera të auditimit, përfshirë auditimet me kërkesë të Kryetarit të Komunës, niveli i rrezikut dhe numri i ditëve të punës do të përcaktohen rast pas rasti, në varësi të natyrës dhe ndërlikueshmërisë së detyrës specifike.

Për të gjitha detyrat e planifikuara audituese janë përcaktuar paraprakisht indeksi i rrezikshmërisë, objektivat e auditimit, fushëveprimi, si dhe periudha kohore e realizimit, duke siguruar një planifikim të qartë, të strukturuar dhe në përputhje me standardet profesionale të auditimit të brendshëm.

Tabela 1: Detyrat e auditimit të planifikuara dhe koha efektive për planin vjetor 2026.

Nr	Njësitë e synuara të auditimit	Indeksi i rrezikut	Prioriteti	Numri i detyrave për 2026	Ditët e punës për person sipas strategjisë audituese
1	Auditimi i shpenzimeve në investime kapitale-Menaxhimi i Kontratave	2.79	L	1	30
2	Auditimi i Menaxhimit të Pasurisë	2.68	L	1	30
3	Auditimi i Procedurave të Prokurimit Publik	2.66	L	1	30
4	Auditimi i Subvencioneve dhe Transfereve në Drejtorinë e Bujqësisë – Auditim i Performances	2.50	L	1	45
5	Auditimi i të hyrave nga tatimi në pronë dhe tatimi në tokë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa	2.21	M	1	20
6	Auditimi i Obligimeve të papaguara për organizatën buxhetore	2.18	M	1	20
<b>Totali për detyrat audituese në pajtim me vlerësimin e rrezikut dhe strategjinë e auditimit</b>				<b>6</b>	<b>175</b>
Detyrat e auditimit që janë duke u zhvilluar nga viti paraparak				-	0
Përcjellja periodike dhe vjetore e rekomandimeve				2	15
Aktivitet e këshillimeve profesionale, punët tjera administrative, takime me KA, trajnimet, punëtoritë, konferencat etj.				-	25
Planifikimi strategjik dhe vjetor				1	10
<b>Numri i ditëve për aktivitetet e auditimit të brendshëm për NjAB</b>				<b>-</b>	<b>50</b>
<b>Numri i përgjithshëm i ditëve për detyrat audituese dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për NjAB</b>				<b>9</b>	<b>225</b>
<b>KEP(Koha efektive e punës ) për secilin auditor për detyrat e shërbimit të sigurisë dhe përcjellja e rekomandimeve/Numri i auditorëve</b>					
Numri i auditorëve të nevojshëm sipas kërkeses ligjore( minimumi i auditorve)				<b>2026</b>	<b>3</b>
Numri aktual i auditorëve në NjAB					<b>2</b>
Numri i auditorëve shtesë të nevojshëm sipas kërkeses ligjore( minimumi i auditorve)					<b>1</b>



Tabela 2: Llojet e detyrave të auditimit

Indeksi i rrezikut	Lloji i detyrës	Njësia strukturore	Objektivi i detyrës	Fushëveprimi i detyrës	Periudha e planifikuar e realizimit të detyrës audituese
/	Përcjellja vjetore e rekomandimeve dhe raporti vjetor për Kryetarin e Komunës dhe NjQHAB/MF	<b>Të gjitha drejtorit e audituara nga viti paraprak</b>	Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve;  Përgatitja e raportit vjetor për Kryetarin e Komunës dhe NjQHAB/MF, lidhur me detyrat e planifikuar dhe të realizuara nga NjAB	Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve për periudhën Janar- Dhjetor 2025;  -Përgatitja e raportit vjetor për periudhën Janar-Dhjetor 2025	Janar 2026
2.50	DSHS 01	<b>Drejtoria e bujqësisë dhe zhvillimit rural</b>	Auditimi i Performances subvencionimi i mekanizmit bujqësor	Auditimi do të vlerësojë performancën e subvencioneve dhe transfereve në sektorin bujqësor, me fokus në efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomicitetin e menaxhimit të programeve të mekanizmit bujqësor. Auditimi do të shqyrtojë planifikimin e subvencioneve, kriteret e ndarjes, procesin e aplikimit dhe aprovimit, shpërndarjen e mjeteve dhe mënyrën e monitorimit të përfituesve. Po ashtu do të vlerësohet ndikimi i subvencioneve në arritjen e objektivave bujqësore dhe funksionimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut. Periudha: janar- dhjetor 2024 dhe janar -dhjetor 2025	Shkurt- mars 2026
2.18	DSHS2	<b>Drejtoria për ekonomi dhe financa dhe të gjitha drejtoritë që kanë deklaruar obligime të paguara</b>	Auditimi i Obligimeve të papaguara për organizatën buxhetore	Të verifikojë nëse obligimet e organizatës buxhetore janë faturuar, regjistruar dhe raportuar saktë, dhe nëse janë në përputhje me ligjin dhe rregulloret për financat publike. Periudha: raportimi në pasqyrat financiare të vitit 2025 dhe periudha janar-mars 2026	Prill 2026
2.21	DSHS3	<b>Drejtoria për ekonomi dhe financa- Zyra e tatimit në pronë</b>	Rregullsitë e procesit të planifikimit dhe inkasimi i të hyrave nga tatimi në pronë dhe tatimit në tokë	Të vlerësojë nëse procesi i planifikimit, regjistrimit dhe inkasimit të hyrave nga tatimi në pronë dhe tatimi në tokë është i saktë, i ligjshëm, i plotë dhe i efektshëm, duke siguruar që organizata buxhetore merr të gjitha të hyrat e ligjshme dhe i raporton ato në mënyrë të besueshme. Periudha: Viti 2025 dhe periudha janar –prill 2026	Maj- qershor 2026
/	Përcjellja periodike e rekomandimeve dhe përgatitja e raportit	<b>Të gjitha drejtoritë dhe zyrat ku janë dhënë rekomandime</b>	Rishikimi i ecurisë mbi implementimin e rekomandimeve, si dhe përgatitja e raportit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026	Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve sipas afateve kohore të parapara në planet e veprimit. Përgatitja e raportit të punës për periudhën janar-qershor 2026	1-15 korrik 2026

	gjashtëmujor për Kryetarin e komunës NjQHAB/MF dhe Komitetin e Auditimit				
2.66	DSHS 04	<b>Zyra e Prokurimit</b>	Pajtueshmëria për proceset e prokurimit me vlera minimale, të vogla, të mesme dhe të mëdha	Rishikimi i pajtueshmërisë në procedurat e prokurimit që nga planifikimi i prokurimit publik deri në fazën e nënshkrimit të kontratës duke përfshirë edhe planin e menaxhimit të kontratës dhe menaxhimi i performances në e-prokurim sipas LPP Periudha: Nëntor- dhjetor 2025 dhe janar – qershor 2025	Korrik-gusht 2026
2.79	DSHS 05	<b>Drejtoria ekonomisë dhe financave- Zyra e thesarit dhe drejtoritë tjera sipas mostrave audituese</b>	Auditimi i shpenzimeve në investime kapitale-Menaxhimi i Kontratave	Të sigurojë që investimet kapitale menaxhohen në mënyrë efektive, në përputhje me kontratat dhe ligjet, dhe që shpenzimet janë të ligjshme, të regjistruar sipas kodeve përkatëse ekonomike si dhe janë raportuar saktë. Periudha: nëntor- dhjetor 2025 dhe janar- gusht 2026	Shtator -tetor 2026
2.68	DSHS 06	<b>E tërë Organizata Buxhetore</b>	Menaxhimi i pasurisë jo financiare në të gjithë organizatën buxhetore	Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë në OB Periudha: janar- tetor 2026	Nëntor-dhjetor 2026
/	Planifikimi strategjik dhe vjetor	/	/	Periudha 2027-2029	Dhjetor 2026

**IV. RADHITJA E DETYRAVE TË PLANIFIKUARA TË AUDITIMIT ME STRATEGJINË E AUDITIMIT**

Tabela 3: Detyrat e auditimit të planifikuara në planin strategjik dhe të paraparë në planin vjetor për NjAB-në

Nr.	Njësia e synuar e auditimit	Indeksi i rrezikut	Prioriteti	E planifikuar për vitin 2026	Nr. i detyrës së auditimit
A.	B.	C.	D.	E.	F.
1	Auditimi i shpenzimeve në investime kapitale-Menaxhimi i Kontratave	2.79	I LARTË	√	DSHS 05
2	Auditimi i Menaxhimit të Pasurisë	2.68	I LARTË	√	DSHS 06
3	Auditimi i Procedurave të Prokurimit Publik	2.66	I LARTË	√	DSHS 04
4	Auditimi i Subvencioneve dhe Transfereve në Drejtorinë e Bujqësisë – Auditim i Performances	2.50	I LARTË	√	DSHS 01
5	Auditimi i të hyrave nga tatimit në pronë dhe tatimi në tokë në Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2.21	I MESËM	√	DSHS 03
6	Auditimi i Obligimeve të papaguara në organizatën buxhetore	2.18	I MESËM	√	DSHS 02
Përcjellja periodike dhe vjetore e rekomandimeve				√	Përcjellja periodike dhe vjetore e rekomandimeve

Detyrat e auditimit të planifikuara për vitin 2026 nuk përputhen plotësisht me planin strategjik, pasi që në planin e punës është parapa auditimi i performancës për Subvencioneve dhe Transfereve në Drejtorinë e Bujqësisë, që rrjedhimisht ky auditim kërkon ditë pune të planifikuar me shumë sa që auditimet e pajtueshmërisë dhe financiar. Prandaj për këtë arsye është një auditim më pak se planifikim strategjik.

Tabela 4: . Raporti në mes të detyrave të planifikuara në planin strategjik dhe në planin vjetor

Llojet e detyrave të auditimit (Detyrat për shërbimet e sigurisë dhe implementimi i rekomandimeve)	Detyrat e auditimit sipas Planit vjetor 2026		Detyrat e auditimit sipas Planit Strategjik 2026-2028	Planifikimi i detyrave sipas rrezikut i shprehur në përqindje për vitin 2026
	Numri i detyrave për vitin 2026	Numri i përgjithshëm i ditëve për person për vitin 2026		
Detyrat për shërbimet e sigurisë	8	190	9	89%
Rrezik i lartë	4	135	4	100%
Rrezik i mesëm	2	40	3	67%
Rrezik i ulët	0	0	0	0%
Përcjellja e rekomandimeve	2	15	2	100%
Detyrat e auditimit që janë duke u zhvilluar nga plani i vitit 2025	/	/	/	/

**V. PLANIFIKIMI I BURIMEVE DHE NDARJA E DETYRAVE TË AUDITIMIT**

**5.1. Koha efektive e punës**

Koha efektive e punës kalkulohet për secilin auditor në NjAB-ja në pajtueshmëri me strategjinë e auditimit dhe pasqyrohet si vijon:

Tabela 5: Koha efektive e punës

Auditorët	Totali i ditëve të punës	Pushimi vjetor	Koha efektive e punës	Planifikim i strategjik dhe vjetor	Përcjellja e rekomandi	Aktivitetet tjetër administrative, Këshillim	Arsimimi profesional	Monitorim i detyrave audituese	Implementimi i detyrave të auditimit
1	2	3	4=2-3	5	6	7	8	9	10=4-(5+6+7+8+9)
Udhëheqësi i AB-së	247	24	223	15	10	55	15	38	90
Auditori i Brendshëm	247	22	225	5	15	10	15	0	180
<b>Totali</b>	<b>496</b>	<b>46</b>	<b>448</b>	<b>20</b>	<b>25</b>	<b>65</b>	<b>30</b>	<b>38</b>	<b>270</b>

Tabela 6: Orari kohor për detyrat e auditimit dhe ndarja e punonjësve të NjAB-së në detyrat e auditimit

Tremujori	Nr. rendor	Detyra e Auditimit	Prioriteti i njësisë së synuar të auditimit	Ditë për person	Udhëheqësi i NjAB	Auditori i brendshëm
					Emri dhe mbiemri	Emri dhe mbiemri
GJM – I-rë	1	Detyra e auditimit për përcjelljen e rekomandimeve	/	8	/	Shpend Berisha
	2	Detyra për shërbimet e sigurisë auditimi performancës - DSHS 01	I lartë	45	Agron Hoxha	Shpend Berisha
	3	Detyra për shërbimet e sigurisë- DSHS 02	I mesëm	20	Agron Hoxha	Shpend Berisha
	4	Detyra për shërbimet e sigurisë- DSHS 03	I mesëm	20	Agron Hoxha	Shpend Berisha
<b>TOTAL DITE PUNE PER GJM –I- rë</b>				<b>93</b>		
GJM – II- të	5	Detyra e auditimit për përcjelljen e rekomandimeve	/	7	/	Shpend Berisha
	6	Detyra për shërbimet e sigurisë- DSHS 04	I lartë	30	Agron Hoxha	Shpend Berisha
	7	Detyra për shërbimet e sigurisë- DSHS 05	I lartë	30	Agron Hoxha	Shpend Berisha
	8	Detyra për shërbimet e sigurisë- DSHS 06	I lartë	30	/	Shpend Berisha
<b>TOTAL DITE PUNE PER GJM –II- të</b>				<b>97</b>		
<b>TOTAL DITE PUNE PER GJM e I dhe II- të</b>				<b>190</b>		

Duke krahasuar nevojat për auditim dhe personelin ekzistues në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, një numër detyrash të auditimit nuk janë përfshi në planin strategjik dhe vjetor, sepse realizimi i tyre në tërësi është i pamundur për shkak kapaciteteve jo të mjaftueshme me staf në raport me buxhetin total të komunës. Ne presim që në të ardhmen, kapacitete për personel në NjAB të funksionojnë në përputhje me Rregulloren nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, **në mënyrë që NjAB të ketë së paku tre(3) auditor të brendshëm të certifikuar**, me qëllim të rritjes së shpeshësisë së auditimeve dhe arritjes së objektivave. Gjithashtu realizimi i planit vjetor do të ndikohet nga bashkëpunimi me Zyrтарin Kryesor Administrativ(Kryetarin e Komunës), me drejtorët e drejtorive, kohëzgjatja e periudhës audituese nga ekipi i ZKA( Zyrës Kombëtare të Auditimit) etj.


## VI.APROVIMI I PLANIT VJETOR

Duke u mbështetur në nenin 23, paragrafi 1.2 i ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, planifikimi vjetor duhet të miratohet nga Zyrtari Kryesor Administrativ( Kryetari i Komunës) dhe nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

Përgatiti:

Aprovimi i planit vjetor:

**Agron Hoxha**  
Udhëheqës i NjAB-së

  
(Nënshkrimi)

**Muharrem Fazliu**  
Kryesues i Komitetit të Auditimit

  
(Nënshkrimi)

**Shaqir Totaj**  
Kryetar i Komunës

  
(Nënshkrimi dhe vula)

Me datë: 22.12.2025

Me datë: 22.12.2025

Me datë: 29.12.25